

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

RAPORT

MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE TË
MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT
PËR VITIN 2025

Tiranë, 2026

HYRJE	4
ANALIZË E PËRGJITHSHME	5
INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR.....	7
Struktura e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik	8
Ndryshimet e planit buxhetor gjatë vitit.....	9
PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI	17
PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT.....	18
1. Performanca financiare e programit buxhetor	18
Programi-Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	18
Programi-Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji.....	19
Programi-Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	20
Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale.....	21
Programi- Inspektimi ne Pune.....	22
Programi – Strehimi	22
Programi-Arsimi i Mesëm (profesional)	23
Programi -Tregu i Punës	25
2. Performanca jo-financiare e programit buxhetor	26
Programi -Tregu i Punës	26
Për programin - Sigurimet Shoqërore	27
Programi - Strehimi	28
Program - Arsimi i Mesëm Profesional.....	29
Program - Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	30
Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale”	31
Programi - Inspektimi në Punë	31
Programi - Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji.....	32
Programi - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	32
Te ardhurat jashtë limit kapitull 06.....	33
Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit nëpër programet.....	34
Përfundimi.....	35

Tabelë 1 Struktura e shpenzimeve	6
Tabelë 2 Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore, viti 2025 ne mije lekë.....	7
Tabelë 3 Realizimi i shpenzimeve në %	7
Tabelë 4 Plani fillestar, plani i rishikuar, realizimi faktik dhe struktura e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, viti 2025	9
Tabelë 5 Ndryshimet e planit buxhetor sipas programeve, viti 2025ne mije leke	10

Hyrje

Ky raport paraqet monitorimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2025 për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në përputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”. Raporti analizon performancën financiare të fondeve buxhetore sipas programeve, strukturës ekonomike të shpenzimeve dhe objektivave të realizuara gjatë vitit buxhetor.

Gjatë periudhës janar–tetor 2025, fondet buxhetore janë administruar në kuadër të grupit buxhetor nr. 12 (ish-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit). Me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 25.09.2025, u krijua Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit si institucion më vete, me grup buxhetor nr. 04, ndërsa me Aktin Normativ nr. 10/2025 u reflektua përshtatja e buxheteve sipas fushave të reja të përgjegjësisë shtetërore. Sqarohet gjithashtu se për vitin 2024 janë administruar në grup 10 dhe 12, sipas AN nr. 2, data 21.02.2025, i cili ndahu fondet buxhetore nga MFE ne MEKI (shtyllën e ekonomisë e bashkoi me kulturën).

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2025 përfaqëson një proces të vazhdueshëm vlerësimi të performancës së fondeve publike, përmes krahasimit të treguesve faktikë me ato të planifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm. Ky proces synon përmirësimin e planifikimit financiar, rritjen e eficiencës së përdorimit të fondeve dhe forcimin e lidhjes ndërmjet burimeve buxhetore dhe rezultateve të politikave publike.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ushtron veprimtarinë e saj në fushat e zhvillimit ekonomik, inovacionit, arsimit dhe formimit profesional, tregut të punës dhe sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Fondet publike janë alokuar për nëntë programe buxhetore që mbështesin këto politika prioritare.

Ky raport ofron një pasqyrë të konsoliduar mbi realizimin e shpenzimeve buxhetore, devijimet nga plani dhe faktorët ndikues, duke shërbyer si instrument për transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të mëtejshëm të menaxhimit financiar publik. Vlerat e detajuara paraqiten në anekset bashkëlidhur.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit administron dhe menaxhon fondet publike sipas nëntë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”
2. Programi “Mbështetje për inovacion dhe teknologji”
3. Programi “Mbështetje për zhvillim ekonomik”
4. Programi “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësisë dhe pronësinë industriale”
5. Programi “Inspektimi në punë”
6. Programi “Strehimi”

7. Programi “Arsimi i mesëm profesional”
8. Programi “Sigurimet shoqërore”
9. Programi “Tregu i punës”

Për vitin 2025, realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas secilit program, krahasuar me planin vjetor të rishikuar (përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet me financim të huaj dhe shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit), paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi i Programit	Realizimi në % ndaj planit vjetor
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	90%
2	Mbështetje për inovacion dhe teknologji	100%
3	Mbështetje për zhvillim ekonomik	91%
4	Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut dhe cilësinë	99%
5	Inspektimi në punë	99%
6	Strehimi	96%
7	Arsimi i mesëm profesional	92%
8	Sigurimet shoqërore	100%
9	Tregu i punës	95%
	TOTALI I MINISTRISË	99%

Analizë e përgjithshme

Nga një vështrim i përgjithshëm mbi realizimin e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2025, niveli i përgjithshëm i realizimit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit paraqitet në masën 99%, duke reflektuar një ecuri shumë pozitive të zbatimit të buxhetit dhe një përputhje të lartë ndërmjet planifikimit financiar dhe realizimit faktik.

Ky nivel realizimi lidhet kryesisht me peshën dominuese të transfertave korente të brendshme, veçanërisht në kuadër të Programit “Sigurimet Shoqërore”, i cili përbën pjesën më të madhe të strukturës së shpenzimeve buxhetore të ministrisë. Gjatë vitit 2025, plani buxhetor i këtij programi është rishikuar si rezultat i miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 29.09.2025 “Për indeksimin e pensioneve”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 16.11.2025 “Për dhënien e bonusit të përfituesve të pensioneve”. Këto masa me karakter social kanë synuar ruajtjen e fuqisë blerëse të pensionistëve dhe mbështetjen financiare të shtresave përfituese, duke sjellë shtim të fondeve të alokuara për këtë program gjatë vitit buxhetor. Rritja e planit është shoqëruar me realizim të plotë të fondeve të miratuara, duke garantuar përmbushjen në kohë të detyrimeve dhe stabilitetin financiar të skemës së sigurimeve shoqërore.

Duke iu referuar Aneksit nr.1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit ndër 9 programet e ministrisë, më poshtë po paraqesim strukturën e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime në nivel vjetor dhe faktit të realizuar gjatë vitit 2025:

Tabelë 1 Struktura e shpenzimeve

Emërtimi i programit	Struktura e shpenzimeve në % plani fillestar	Struktura e shpenzimeve në % sipas planit të rishikuar	Struktura e shpenzimeve në % sipas faktit
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0%	0%	0%
Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	1%	2%	2%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	1%	2%	1%
Mbështetje për Mbikëqyrjen Tregut, Infrastruktura Cilësisë & Pronësia Industriale	1%	1%	1%
Inspektimi në Punë	1%	0%	0%
Strehimi	3%	2%	2%
Arsimi Mesëm Profesional	9%	7%	6%
Sigurimet Shoqërore	79%	82%	82%
Tregu i Punës	6%	5%	4%
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	100%	100%	100%

Në të njëjtën kohë, shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në nivele të qëndrueshme, duke garantuar funksionimin normal të strukturave të ministrisë dhe institucioneve të varësisë. Megjithatë, gjatë vitit 2025, procesi i riorganizimit institucional dhe tranzicioni drejt krijimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit si strukturë më vete ka ndikuar në nivelin e realizimit të fondeve të personelit, për shkak të vakancave të përkohshme në disa struktura dhe fazës së konsolidimit organizativ.

Mosrealizimi i pjesshëm i disa fondeve, kryesisht në zërin e shpenzimeve kapitale, është ndikuar nga fazat e zbatimit të projekteve të investimit, ritmi i disbursimit të fondeve me financim të huaj, lejet e ndërtimeve të shkollave të AMP, si dhe rishikimet buxhetore të kryera gjatë vitit në funksion të përshtatjes së fushave të përgjegjësisë shtetërore.

Për një vlerësim më real të ecurisë së shpërndarjes së fondeve buxhetore ndërmjet programeve, në analizën strukturore është përjashtuar Programi “Sigurimet Shoqërore”, për shkak të peshës së tij dominuese në totalin e shpenzimeve të ministrisë. Duke përjashtuar këtë program, shpërndarja e fondeve për vitin 2025 rezulton më e balancuar, me përqendrim kryesor në programet e zhvillimit ekonomik, arsimin profesional, strehimit dhe tregut të punës. Në një nivel dytësor renditen programet administrative si dhe ato me funksion mbikëqyrës dhe politikëbërës. Krahasimi ndërmjet buxhetit fillestar, buxhetit të rishikuar dhe realizimit faktik tregon se shpërndarja e fondeve ka ruajtur në përgjithësi qëndrueshmëri gjatë vitit, me ndryshime të kufizuara që lidhen kryesisht me rregullime teknike të planit buxhetor dhe ritmin e zbatimit të projekteve. Kjo e vë në dukje se orientimi i burimeve financiare ka mbetur i qëndrueshëm ndaj prioriteteve strategjike të institucionit, pa devijime të ndjeshme gjatë procesit të zbatimit.

Në tërësi, performanca financiare e vitit 2025 paraqet një menaxhim efektiv dhe të qëndrueshëm të burimeve publike, duke garantuar realizimin e prioriteteve strategjike dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të institucionit.

INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Për vitin 2025, plani vjetor i rishikuar i shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit është në vlerën 56,696,106 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike progresive janë realizuar në masën 56,099,486 mijë lekë, duke reflektuar një nivel realizimi prej 99% të planit të rishikuar.

Tabelë 2 Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore, viti 2025 në mijë lekë

Përshkrimi	Plani fillestar 2025	Plani i rishikuar 2025	Shpenzime faktike	Realizimi %
Shpenzime korente	48,840,550	54,150,638	53,905,450	100%
Shpenzime kapitale	2,570,159	2,545,468	2,194,036	86%
Totali buxhetor	51,410,709	56,696,106	56,099,486	99%

Në krahasim me planin fillestar vjetor, buxheti i ministrisë është rishikuar në rritje me 5,285,397 mijë lekë, si rezultat i shtesave buxhetore të miratuara gjatë vitit dhe rialokimeve në funksion të përmbushjes së prioriteteve sociale dhe institucionale.

Sipas zërave të shpenzimeve buxhetore, duke përjashtuar edhe të ardhurat jashtë limitit, niveli i realizimit është 99 % dhe situata për çdo program për vitin 2025 paraqitet e tillë:

Tabelë 3 Realizimi i shpenzimeve në %

Emërtimi i Programit	Realizimi i shpenzime korente 2025 (%)	Shpenzime kapitale të brendshme 2025 (%)	Totali i shpenzimeve buxhetore 2025 (%)
Planifikim, menaxhim dhe administrimi	83%	94%	90%
Mbështetje për inovacion dhe teknologji	99%	100%	100%
Mbështetje për zhvillim ekonomik	96%	56%	91%
Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut dhe cilësinë	99%	99%	99%
Inspektimi në punë	99%	98%	99%
Strehimi	96%	97%	96%
Arsimi i mesëm profesional	97%	69%	92%
Sigurimet shoqërore	100%		100%
Tregu i punës	96%	53%	95%
TOTALI I MINISTRISË	100%	86%	99%

Për të gjitha programet në nivel Ministrie realizimi i shpenzimeve korente paraqitet me 100 % duke variuar nga më i ulëti Programi “PMA” me 83% e deri tek Në mosrealizimin deri në nivelin e planifikimit të shpenzimeve korente ka ndikuar mosrealizimi në shpenzime për paga për

mosplotësim të strukturave të miratuara në të gjithë programet, mosrealizimi në shpenzimet për mallra dhe shërbime si rrjedhojë e procedurave të prokurimit. Efektet e riorganizimit u reflektuan në realizimin e fondeve si dhe riorganizimit të Aparatit MEI.

Nga analiza e realizimit të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për vitin 2025, evidentohet një nivel shumë i lartë i realizimit të shpenzimeve korente në pothuajse të gjitha programet, duke reflektuar përmbushjen në kohë të detyrimeve për paga, transfertat dhe shpenzime operationale. Në të njëjtën kohë, realizimi i shpenzimeve kapitale të brendshme paraqet diferenca ndërmjet programeve, të ndikuara kryesisht nga fazat e zbatimit të projekteve të investimit, ritmi i kontraktimit dhe procedurat e disbursimit gjatë vitit buxhetor. Programet me komponent më të lartë investimesh, si “Mbështetje për zhvillim ekonomik” dhe “Arsimi i mesëm profesional”, paraqesin realizim më të moderuar të fondeve kapitale, ndërkohë që programet administrative dhe rregullatore evidentojnë realizim pothuajse të plotë. Në tërësi, totali i shpenzimeve buxhetore të ministrisë është realizuar në masën 99%, duke reflektuar një menaxhim efektiv të fondeve publike dhe një përputhje të lartë ndërmjet planifikimit dhe ekzekutimit faktik.

Po kështu në zërin e shpenzimeve kapitale të brendshme, Ministria paraqitet me realizim prej 86% ndaj planit vjetor të rishikuar, shkak kryesor që ka ndikuar në këtë realizim është se fondet janë në procesin e prokurimit si dhe lëvizjet e fondeve të bëra gjatë kësaj periudhe, ndërsa struktura e miratimit të tyre paraqitet si më poshtë:

- fonde të kontraktuara (kontrata në vazhdim)
- fonde që nuk prokurohen (tvsh, leje ndërtimi etj)
- fonde që prokurohen nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara
- fonde që prokurohen nga AKSHI
- fonde që do prokurohen nga strukturat e Ministrisë

Gjatë kësaj periudhe rezultojnë se njësitë shpenzuese/programeve, kanë dërguar procedurat në Operatorin e Blerjeve të Përqendruara dhe të AKSHI për projekte që do prokurohen nga këto institucione, po komunikohet mbi ecurinë e procedurave të prokurimit si dhe janë lidhur disa kontrata nga fondet që prokurohen nga strukturat e Ministrisë.

Realizimi i fondeve me financim të brendshëm në këtë periudhë i referohet likuidimit të projekteve që janë në vazhdim në përputhje me ecurinë fizike të tyre si dhe janë likuiduar kontratat e lidhura gjatë kësaj periudhe.

Struktura e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

Shpenzimet korente përbëjnë pjesën kryesore të buxhetit të ministrisë për vitin 2025, me një realizim faktik në vlerën 53,905,450 mijë lekë ndaj një plani të rishikuar prej 54,150,638 mijë lekë, duke reflektuar një nivel realizimi pothuajse të plotë.

Në strukturën e shpenzimeve korente dominojnë transfertat korente të brendshme, të cilat lidhen kryesisht me pagesat për sigurimet shoqërore, si dhe shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore,

të realizuara në nivele të qëndrueshme gjatë vitit buxhetor. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, si dhe subvencionet, paraqesin realizim më të moderuar, të ndikuar nga ritmi i procedurave të prokurimit dhe planifikimi i kontratave gjatë vitit.

Shpenzimet kapitale për vitin 2025 janë realizuar në vlerën 2,194,036 mijë lekë ndaj një plani të rishikuar prej 2,545,468 mijë lekë, me nivel realizimi 86%. Mosrealizimi i plotë i fondeve kapitale lidhet kryesisht me fazat e zbatimit të projekteve të investimit, vonesat në disbursimin e fondeve me financim të huaj, si dhe rishikimet buxhetore të kryera gjatë vitit.

Tabelë 4 Plani fillestar, plani i rishikuar, realizimi faktik dhe struktura e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, viti 2025

Nr	Emri i Programit	Plani fillestar 2025	Plani i rishikuar 2025	Struktura % (plan i rish.)	Fakti 2025	Realizimi %	Struktura faktike %
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	80,000	156,960	0.3	141,646	90	0.3
2	Mbështetje për inovacion dhe teknologji	349,388	1,113,976	2.0	1,111,545	100	2.0
3	Mbështetje për zhvillim ekonomik	676,309	894,888	1.6	810,549	91	1.4
4	Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut dhe cilësinë	389,922	407,361	0.7	402,504	99	0.7
5	Inspektimi në punë	282,984	282,371	0.5	279,060	99	0.5
6	Strehimi	1,295,000	1,105,113	2.0	1,066,165	96	1.9
7	Arsimi i mesëm profesional	4,510,469	3,842,512	6.8	3,524,426	92	6.3
8	Sigurimet shoqërore	40,800,090	46,284,132	81.6	46,280,277	100	82.5
9	Tregu i punës	3,026,547	2,608,793	4.6	2,483,315	95	4.4
	TOTALI I MINISTRISË	51,410,709	56,696,106	100	56,099,486	99%	100

Ndryshimet e planit buxhetor gjatë vitit

Nga krahasimi i planit fillestar me planin vjetor të rishikuar për vitin 2025, rezulton se buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit është rritur me 5,285,397 mijë lekë gjatë vitit, si rezultat i rishikimeve buxhetore të miratuara në funksion të përmbushjes së prioritetëve sociale dhe institucionale. Rritja më e ndjeshme është evidentuar në Programin “Sigurimet Shoqërore”, i ndikuar nga shtesat e fondeve për indeksimin e pensioneve dhe dhënien e bonuseve për pensionistët, si dhe në Programin “Mbështetje për inovacion dhe teknologji”, në kuadër të mbështetjes së politikave për zhvillimin teknologjik dhe nxitjen e inovacionit.

Në të njëjtën kohë, disa programe paraqesin ulje të planit vjetor krahasuar me planin fillestar, veçanërisht në programet e strehimit, arsimit profesional dhe tregut të punës, si rezultat i rialokimeve buxhetore dhe përshtatjes së fondeve me ritmin real të zbatimit gjatë vitit. Programet

administrative dhe rregullatore kanë shfaqur ndryshime minimale të planit, duke reflektuar stabilitet në financimin e funksioneve bazë të institucionit.

Në tërësi, ndryshimet buxhetore gjatë vitit 2025 kanë synuar rritjen e eficiencës në përdorimin e fondeve publike dhe përshtatjen e planifikimit financiar me nevojat reale të zbatimit të politikave publike.

Tabelë 5 Ndryshimet e planit buxhetor sipas programeve, viti 2025ne mije leke

Kodi i Programit	Emërtimi	Plani fillestar 2025	Plani vjetor i rishikuar 2025	Ndryshimi i planit vjetor
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	80,000,000	156,960,000	76,960,000
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	349,388,000	1,113,976,000	764,588,000
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	676,309,000	894,888,000	218,579,000
04160	Mbështetje për Mbikqyrjen Tregut, Infrastruktura Cilësisë & Pronësia Industriale	389,922,000	407,361,000	17,439,000
04170	Inspektimi në Punë	282,984,000	282,371,000	-613,000
06190	Strehimi	1,295,000,000	1,105,113,000	-189,887,000
09240	Arsimi Mesëm Profesional	4,510,469,000	3,842,512,245	-667,956,755
10220	Sigurimet Shoqërore	40,800,090,000	46,284,132,000	5,484,042,000
10550	Tregu i Punës	3,026,547,000	2,608,793,000	-417,754,000
	Total i Ministse	51,410,709,000	56,696,106,245	5,285,397,245

Për vitin 2025 buxheti i miratuar u detajua sipas Ligjit nr. 115/2024. Siç e dhe u citua me sipër gjatë vitit buxheti pësoi ndryshime, të cilat konsistojnë në ndryshime, shtesa të fondit të veçantë, si dhe akte normative dhe VKM.

Tabela më poshtë paraqet planin e rishikuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Ligji i buxhetit nr. 115/2024, është miratuar detajimi si me poshtë:

- Shkrese e MF, protokolluar në MEKI me nr.16474/1, datë 22.01.2025 për shpenzime korrente; - Shkrese e MF, protokolluar në MEKI me nr.3211, datë 26.02.2025 për shpenzime kapitale;
- Shkrese e MF, protokolluar në MEKI me nr.3771/1, datë 19.03.2025 për shpenzime kapitale;
- Shkrese e MF, protokolluar në MEKI me nr.1658/2, datë 05.05.2025 për shpenzime kapitale

Transferime dhe Fond i veçantë:

- Fondi veçantë sipas shkrese se MF protokolluar me tonën nr. 2503/1, datë 18.03.2025;
- Fondi veçantë sipas shkrese se MF.

Akte Normative:

- AN nr. 3, datë 30.04.2025
- AN nr.6, date 11.06.2025;
- AN nr.10, date 08.10.2025;
- AN nr. 11, date 19.12.2025.

Vendime të Këshillit të Ministrave:

- VKM nr. 540, datë 29.09.2025 “Për indeksimin e pensioneve”;
- VKM nr. 711, date 26.11.2025 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2025”

Programet	Emertimi i programit	Plan Fillestar Viti 2025	AN nr.3	AN nr.6	AN nr.10	AN nr.11	Buxheti i rishikuar sipas Ligjit	VKM nr.540, date 29.09.2025	FV sipas shkr. Nr. 16372/1, date 25.11.2025	FV sipas shkr. Nr. 2503/1, date 19.03.2025	Fondi i vecante SKEK dhe Agjensia e Startap	VKM nr. 711, date 26.11.2025	Buxheti i rishikuar sipas Ligjit
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi gr 12	80,000,000			7,500,000	11,260,000	98,760,000						98,760,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi gr 04				105,000,000	(46,800,000)	58,200,000						58,200,000
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	349,388,000	1,000,000,000	(185,800,000)		(49,712,000)	1,113,876,000			100,000			1,113,976,000
04130	Mbështetje per Zhvillim Ekonomik	676,309,000		(2,000,000)	352,271,000	(132,265,000)	894,315,000			373,000	200,000		894,888,000
04160	Mbështetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	389,922,000		2,000,000	32,710,000	(18,287,000)	406,345,000		116,000	900,000			407,361,000
10220	Sigurimi Shoqëror	40,800,090,000			(5,327,000,000)		35,473,090,000	1,111,042,000				9,700,000,000	46,284,132,000
10550	Tregu i Punës	3,026,547,000			(64,000,000)	(355,984,000)	2,606,563,000		1,230,000	1,000,000			2,608,793,000
04170	Inspektimi ne Pune	282,984,000			9,600,000	(10,613,000)	281,971,000			400,000			282,371,000
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	4,510,469,000			(14,908,000)	(659,506,000)	3,836,055,000		2,987,246	3,470,000			3,842,512,246
06190	Strçhimi	1,295,000,000				(189,887,000)	1,105,113,000						1,105,113,000
	Totali	51,410,709,000	1,000,000,000	(185,800,000)	(4,898,827,000)	(1,451,794,000)	45,874,288,000	1,111,042,000	4,333,246	6,243,000	200,000	9,700,000,000	56,597,346,246

Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi

Në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ nr. 10/2025 dhe riorganizimit institucional që çoi në krijimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit si strukturë më vete, Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” ka pësuar ndryshime të rëndësishme në strukturën e financimit gjatë vitit 2025. Në zbatim të këtij akti normativ, shpenzimet korente të këtij programi janë transferuar pranë aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, ndërsa fondet për investime janë alokuar në kuadër të Programit 01110 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, e cila filloi funksionimin në muajin tetor 2025.

Në total për periudhën 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 76, 960 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601, kemi shtese fondi në shumën 23,200 mijë lekë.

Në artikullin 602, kemi shtesë fondi në shumën 20,000 mijë lekë.

Në artikullin 605, kemi shtesë fondi në shumën 15,000 mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi shtesë fondi 18,760 mijë lekë, që ka të bëjë me një projekt e godinës dhe pajisje.

2. Programi Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji

Në total për periudhën 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 764,588 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601, kemi pakësim shtesë fondi në shumën 46,343 mijë, si rezultat i rishikimeve buxhetore të kryera nëpërmjet akteve normative. Ky ndryshim lidhet kryesisht me ekzistencën e vakancave në strukturën organike të Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës, të cilat kanë ndikuar në realizimin më të ulët të shpenzimeve të personelit krahasuar me planifikimin fillestar.

Në artikullin 602, kemi pakësim fondi në shumën 6,419, mijë lekë, si rezultat i rishikimeve buxhetore të kryera nëpërmjet akteve normative, duke qene se kryesisht fondet e alokuar për AIE nuk u arritën te prokurohen ne bashkëpunim me OBP.

Në artikullin 231 kemi shtesë fondi në shumën 817,200 mijë lekë që ka të bëjë me projektin e MachineLab. Gjatë vitit 2025 është reflektuar një shtesë fondi në shumën 867,200 mijë lekë, e lidhur me financimin e projektit “MachineLab”, si një investim strategjik në infrastrukturën e inovacionit dhe teknologjive të avancuara. Projekti synon krijimin dhe pajisjen e një laboratorit modern për zhvillimin e aftësive teknike, kërkimin e aplikuar dhe testimin e zgjidhjeve të reja teknologjike, në veçanti në fushën e inteligjencës artificiale dhe automatizimit. Ky investim do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve kombëtare për inovacion, mbështetjen e ekosistemit të sipërmarrjes teknologjike dhe përmirësimin e shërbimeve publike përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore. Alokimi shtesë i fondeve është realizuar në funksion të përshpejtimit të zbatimit të projektit dhe sigurimit të standardeve moderne të pajisjeve dhe infrastrukturës përkatëse.

Paralelisht, në kuadër të riorganizimit të projekteve digjitale, është reflektuar pakësimi i fondeve në vlerën 50,000 mije leke për vitin 2025 dhe për gjithë vlerën e projektit për vitet e tjera për projektin për biletimin online, për shkak të transferimit të këtij funksioni pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në funksion të centralizimit dhe eficiencës së shërbimeve digjitale publike. Alokimi dhe rialokimi i fondeve janë kryer me qëllim optimizimin e përdorimit të burimeve publike dhe orientimin e investimeve drejt projekteve me impakt më të lartë strategjik.

3. Programi Mbështetje për Zhvillim Ekonomik

Në total për periudhën vitin 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 218,579 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm. Në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ nr. 10/2025 dhe procesit të riorganizimit institucional të agjencive në rang vendi, në Programin “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” janë transferuar dy institucione nga grupi buxhetor 87, konkretisht Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e Startup-eve dhe Lehtësuesve, së bashku me fondet buxhetore përkatëse që u ishin alokuar për vitin 2025. Deri në muajin tetor 2025, këto institucione kanë operuar financiarisht në

kuadër të grupit 87, ndërsa me hyrjen në fuqi të Aktit Normativ nr. 10/2025 fondet e disponueshme janë transferuar dhe reflektuar në Programin 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik”, duke rritur strukturën buxhetore të këtij programi në funksion të fushave të reja të përgjegjësisë shtetërore.

Në artikullin 600 dhe 601, kemi pakësim neto fondi në shumën 4,174 mijë, si rezultat i rishikimeve buxhetore të kryera nëpërmjet akteve normative. Ky ndryshim lidhet kryesisht me ekzistencën e vakancave në strukturën organike.

Në artikullin 602, kemi shtese fondi në shumën 34,466, mijë lekë, si rezultat i rishikimeve buxhetore të kryera nëpërmjet akteve normativeve të shpjeguara më sipër.

Në artikullin 604, kemi rritje të fondit me 290,000, mijë lekë, si rezultat i fondeve që ka pasur Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e Startup-eve dhe Lehtësuesve në këtë artikull.

Në artikullin 606 kemi një rritje të moderuar prej 573 mijë lekë në vijim të rialokimeve buxhetore të kryera gjatë vitit 2025, siç është shpjeguar më sipër. Këtu përfshihet detajimi i fondit të veçantë dhe pagesa për individë.

Në artikullin 231 është reflektuar një pakësim fondi në shumën 102,286 mijë lekë, i ndikuar kryesisht nga pakësimi i financimit të huaj në vlerën rreth 100 milionë lekë, si dhe nga përshtatja e fondeve për disa institucione në përputhje me ecurinë e realizimit të investimeve gjatë vitit, nëpërmjet akteve normative. Në këtë kuadër, për blerjen e pajisjeve kompjuterike për ATRAKO në vlerën 2,311 mijë lekë, Operatori i Prokurimeve të Përqendruara ka njoftuar për lidhjen e kontratës në muajin janar, çka ka bërë që fondet e parashikuara për vitin 2025 të mos arrijnë të përdoren brenda periudhës buxhetore. Gjithashtu, fondet për TVSH-në e projekteve me financim të huaj janë realizuar në varësi të ritmit të zbatimit të projekteve përkatëse.

4. Programi Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale

Në total për periudhën vjetore 2025 kemi rritje të buxhetit në vlerën 17,439 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve të mëposhtëm:

Në artikujt 600 “Paga” dhe 601 “Sigurime shoqërore”, në kuadër të Programit 04160 është reflektuar një shtesë neto fondi në shumën 25,260 mijë lekë, si rezultat i rishikimeve buxhetore të kryera nëpërmjet akteve normative, e lidhur kryesisht me përshtatjen e strukturës së personelit dhe nevojat funksionale të institucioneve përbërëse të programit.

Në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, është evidentuar një shtesë fondi në shumën 1,800 mijë lekë, në funksion të mbulimit të shpenzimeve operative për mbikëqyrjen e tregut, standardizimin dhe proceset e akreditimit.

Në artikullin 605 “Transferta korente të huaja”, është reflektuar një pakësim fondi në shumën 6,797 mijë lekë, si rezultat i rialokimeve buxhetore dhe përshtatjes së fondeve me ecurinë reale të angazhimeve ndërkombëtare gjatë vitit.

Në artikullin 606 “Transferta për buxhete familjare dhe individë”, është shënuar një shtesë fondi në shumën 1,016 mijë lekë, në vijim të detajimit të fondeve dhe mbulimit të pagesave specifike sipas politikave përkatëse.

Në artikullin 231 “Kapitale të trupëzuara”, është reflektuar një pakësim fondi në shumën 3,840 mijë lekë, si rezultat i përfundimit të procedurës së prokurimit me vlerë më të ulët se fondi limit i planifikuar fillimisht i DPM-se. Për pasojë, diferenca e krijuar nga tenderimi është reflektuar nëpërmjet aktit normativ përkatës, duke sjellë pakësimin e fondeve të parashikuara për investimin në përputhje me vlerën reale kontraktuale.

Në tërësi, ndryshimet buxhetore në Programin 04160 kanë synuar përshtatjen e financimit me nevojat reale operative dhe ecurinë e investimeve, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm të strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, standardizimin dhe pronësinë industriale. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 është evidentuar gjithashtu një mangësi fillestare në fondet e shpenzimeve të personelit për disa institucione në varësi, konkretisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Kjo mangësi është korrigjuar gjatë vitit nëpërmjet akteve normative, duke garantuar mbulimin e plotë të shpenzimeve të personelit dhe funksionimin normal të strukturave përkatëse.

5. Programi Inspektimi në Punë

Në total për periudhën vjetore 2025 kemi pakësim të buxhetit nga buxheti fillestar në vlerën 613,000 mijë lekë, konkretisht sipas artikujve të mëposhtëm:

Në artikullin 600 “Paga” është reflektuar një shtesë fondi në shumën 5,060 mijë lekë, për të garantuar mbulimin e plotë të shpenzimeve të personelit.

Në artikullin 601 “Sigurime Shoqërore” është reflektuar një pakësim fondi në shumën 9,073 mijë lekë, në përputhje me dinamikën reale të shpenzimeve të personelit gjatë vitit.

Në artikullin 602 “Mallra dhe Shërbime të tjera” është reflektuar një shtesë fondi prej 3,000 mijë lekë, për të mbështetur aktivitetin operacional të inspektimeve në terren.

Në artikullin 606 “Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë” është reflektuar një shtesë fondi prej 400 mijë lekë, si fond i veçantë.

Në artikullin 231 “Kapitale të trupëzuara” plani i rishikuar prej 22,000 mijë lekë është realizuar në masën 98%, duke reflektuar investimet për pajisje, automjete dhe mjete teknologjike të nevojshme për ushtrimin e funksionit inspektues. Diferenca prej 478 mijë lekë lidhet me kursimet e krijuara nga procedurat e prokurimit.

6. Programi Strehimi

Programi “Strehimi” përbën një nga programet me rëndësi strategjike për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, duke synuar mbështetjen sociale të shtresave në nevojë dhe përmirësimin e kushteve të banimit. Për vitin 2025, plani fillestar i programit ka qenë 1,295,000 mijë lekë, ndërsa

plani i rishikuar 1,105,113 mijë lekë, duke reflektuar një pakësim neto prej 189,887 mijë lekë nëpërmjet rishikimeve buxhetore të kryera gjatë vitit.

Në shpenzimet korrente, konkretisht **në artikullin 606** “Transferta për buxhete familjare dhe individë”, është reflektuar një pakësim fondi në shumën 209,982 mijë lekë, si rezultat i përshtatjes së fondeve me ecurinë reale të skemave të subvencionimit të kredive dhe mbështetjes për qira, duke ruajtur megjithatë një nivel shumë të mirë realizimi prej 95.6%.

Në të kundërt, në shpenzimet kapitale, **në artikullin 231** “Kapitale të trupëzuara”, është evidentuar një shtesë fondi në shumën 20,095 mijë lekë, e orientuar drejt projekteve të investimit për strehim social dhe përmirësimin të infrastrukturës në zona informale dhe komunitete në nevojë. Realizimi i shpenzimeve kapitale rezulton në nivelin 97.3%, duke dëshmuar një ecuri shumë pozitive të investimeve gjatë vitit.

7. Arsimi i Mesëm (profesional)

Programi “Arsimi i Mesëm Profesional” përbën një program me peshë të lartë në buxhetin e Ministrisë, për shkak të mbështetjes së drejtpërdrejtë të arsimit dhe formimit profesional, përfshirë financimin e nxënësve, bursave, suvencionim tekstesh, si dhe investimeve në infrastrukturën arsimore dhe projektet me financim të huaj. Për vitin 2025, plani fillestar i programit ka qenë 4,510,469 mijë lekë, ndërsa plani i rishikuar 3,842,512 mijë lekë, duke reflektuar një pakësim neto prej 667,957 mijë lekë nëpërmjet rishikimeve buxhetore të kryera gjatë vitit nëpërmjet AN-ve.

Në shpenzimet korrente, është reflektuar përgjithësisht një ulje e fondeve, e cila lidhet me përshtatjen e planit me ecurinë reale të realizimit gjatë vitit.

Konkretisht, **në artikullin 600 “Paga”** është reflektuar pakësimi prej 24,577 mijë lekë dhe **në artikullin 601 “Sigurime shoqërore”** pakësim prej 23,919 mijë lekë. Diferenca në artikullin 600 dhe 601, rezulton kryesisht nga mosplotësimi i plotë i organikës dhe vakancat e krijuara gjatë vitit buxhetor.

Në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime” është reflektuar pakësimi prej 28,620 mijë lekë, me realizim 90.4%, në varësi të ritmit të shpenzimeve operative.

Në artikullin 606 “Transferta për buxhete familjare dhe individë” është evidentuar shtesë fondi prej 3,978 mijë lekë. Shtesa prej 3,978 mijë lekë në këtë lidhet me çeljen e fondeve për bashkitë, në kuadër të financimit të bursave për nxënësit e arsimit të mesëm profesional (AMP).

Në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm është evidentuar pakësimi i konsiderueshëm i planit, ku **në artikullin 231 “Kapitale të trupëzuara”** plani është ulur me 564,820 mijë lekë dhe në total shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë 213,649 mijë lekë, duke qenë se një pjesë e investimeve është rishikuar sipas ecurisë së projekteve dhe fazave të realizimit gjatë vitit. Mos-pajisja në kohë me leje ndërtimore për një pjesë të projekteve të investimit ka sjellë mospërputhje ndërmjet realizimit fizik dhe atij financiar, duke ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e zbatimit të projekteve dhe në nivelin e shpenzimeve kapitale gjatë vitit raportues kryesisht nëpërmjet AN nr. 11. Realizimi i kapitaleve me financim të brendshëm rezulton shumë i lartë (99.2%), duke treguar se fondet e mbetura në plan janë përdorur në mënyrë efektive.

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj, plani vjetor i rishikuar ka qenë 570,000,000 mijë lekë, ndërsa realizimi progresiv rezulton 330,842,340 mijë lekë, me nivel realizimi rreth 58.0%. Ky nivel

realizimi është në varësi të ritmit të zbatimit të projekteve të financuara, procedurave, si dhe disbursimeve përkatëse gjatë vitit.

8. Tregu i punës

Në artikullin 600 – Paga, kemi shtesë fondi në shumën 19,906 mijë lekë, si rezultat i rishikimeve buxhetore të kryera gjatë vitit nëpërmjet akteve normative dhe rialokimeve, për të mbuluar nevojat reale të strukturave të shërbimit të punësimit.

Në artikullin 601 – Sigurime shoqërore, është reflektuar shtesë fondi në shumën 4,923 mijë lekë, në vijim të rritjes së fondit të pagave dhe përshtatjes së detyrimeve përkatëse.

Në artikullin 602 – Mallra dhe shërbime të tjera, kemi pakësim fondi në shumën 3,815 mijë lekë, si rezultat i rialokimeve buxhetore gjatë vitit dhe ecurise se procedurave.

Në artikullin 603 – Subvencione, evidentohet shtesë fondi në shumën 33,542 mijë lekë, e orientuar drejt programeve të nxitjes së punësimit dhe mbështetjes sociale.

Në artikullin 604 – Transferta korente të brendshme, është realizuar pakësim fondi në shumën 200,000 mijë lekë, si pasojë e riplanifikimit të kësaj kategorie shpenzimesh në kuadër të rishikimeve buxhetore duke e kaluar me artikullin 603.

Në artikullin 606 – Transferta për familje dhe individë, kemi pakësim fondi në shumën 92,510 mijë lekë, i lidhur me rishikimin e skemave të pagesave sociale dhe ritmin real të përfitimeve gjatë vitit.

Në artikullin 231 – Kapitale të trupëzuara (financim i brendshëm), është reflektuar pakësim fondi në shumën 109,800 mijë lekë, kryesisht për shkak të shtyrjes dhe riplanifikimit të projekteve investuese.

Në artikullin 231 – Kapitale të trupëzuara (financim i huaj), evidentohet pakësim fondi në shumën 70,000 mijë lekë, si rezultat i rishikimit të fondeve për projektet me financim të huaj dhe ecurisë së tyre gjatë vitit.

Gjatë vitit 2025 janë kryer gjithsej 23 transferime buxhetore, nga të cilat 2 transferime janë kryer me akte normative dhe 21 transferime të tjera janë realizuar brenda vitit për përshtatjen e planit me ecurinë e zbatimit. Transferimet e brendshme kanë mbuluar kryesisht lëvizjet për fondin e veçantë, rishpërndarjet për pagesën e papunësisë dhe programin e nxitjes së punësimit, kalimin e fondeve nga artikulli 604 në artikullin 603, si dhe rregullime për artikujt 600, 601 dhe 602.

9. Sigurimi Shoqëror

Ky program karakterizohet nga shpenzime shumë të kufizuara korrente të alokuara në aparatën administrativ (artikujt 600 dhe 601), ndërsa pothuajse e gjithë pesha buxhetore është përqendruar në artikullin 604 – Transferta korente të brendshme, i cili përfaqëson financimin e skemave të sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve sociale. Për rrjedhojë, ndryshimet buxhetore gjatë vitit janë reflektuar kryesisht në këtë artikull, në funksion të mbulimit të nevojave shtesë të skemës sipas VKM nr. 711/2025 dhe 540/2025, si dhe rishikimeve të buxhetit me AN.

Numri i rialokimeve të miratuara:

Deri në fund të periudhës, përveç shtesave që përmendëm dhe më sipër për çelje e fondit të veçantë, shtesë buxheti me VKM si dhe shtesë me Akt Normativ, kemi miratuar transferime që kanë të

bëjnë me plotësimin e nevojave që kanë paraqitur programet buxhetore si dhe disa avancime fondesh.

Me shume informacion gjeni ne anekset 2.

Numri i punonjësve

Numri total i punonjësve i planifikuar për vitin 2025 është 3,129 punonjës, ndërsa numri faktik për periudhën raportuese rezulton 3,012 punonjës (përfshi këtu edhe 5 punonjës faktike të DPZAM). Shpërndarja sipas programeve buxhetore pasqyron strukturën organizative dhe peshën relative të burimeve njerëzore në totalin e institucionit, ku përqindjet e paraqitura përfaqësojnë strukturën e punonjësve sipas programeve dhe jo nivelin e realizimit të planit të punësimit.

Struktura paraqitet si më poshtë:

- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi – 231 plan / 181 fakt (7% plan, 6% fakt)
- Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji – 75 / 44 (2% / 1%)
- Mbështetje për Zhvillim Ekonomik – 162 / 149 (5% / 5%)
- Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale – 219 / 197 (7% / 7%)
- Inspektimi në Punë – 163 / 159 (5% / 5%)
- Arsimi i Mesëm Profesional – 1,805 / 1,826 (58% / 61%)
- Tregu i Punës – 474 / 456 (15% / 15%).

Ndikimi i Aktit Normativ nr. 10

Gjithashtu, Akti Normativ nr. 10 ka ndikuar në ndryshimin e strukturës së punonjësve, duke qenë se në buxhetin fillestar ishin të detajuara edhe dy programe të tjera, të cilat me miratimin e këtij akti dhe VKM përkatëse kaluan në fushën e përgjegjësisë së MTKS, çka ka reflektuar në rishpërndarjen e numrit të punonjësve të aparatit dhe në përbërjen e përgjithshme të strukturës së MEI-së për periudhën raportuese.

Për informacion përmbledhës, lutemi referojuni Aneksit nr. 1: Raporti i Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor.

PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Të gjitha programet buxhetore të Ministrisë, në respektim dhe promovim të plotë të barazisë gjinore, kanë përcaktuar tregues gjinorë konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm në nivel qëllimi dhe objektivi. Gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor (Ministria e Financave), nga të gjithë programet buxhetore janë përfshirë edhe disa tregues kyç të performancës që lidhen me buxhetimin mbi bazë gjinore dhe vlerat e synuara për këto tregues janë bërë pjesë e raporteve të monitorimit.

PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

1. Performanca financiare e programit buxhetor

Programi-Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi

Plani vjetor i rishikuar për vitin 2025 për Programin 01110 rezulton në 156,959 mijë lekë. Realizimi faktik progresiv për periudhën raportuese është 141,645 mijë lekë, ose 90.2% e planit të rishikuar. Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 0.3% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI për periudhën raportuese

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën 83.2%,
Nga të cilat:
Shpenzime për personelin dhe stafin e trajnuar, në masën 90%,
Shpenzime të tjera korente (raporte dhe akte ligjore), në masën 72.9%,
- Shpenzime Kapitale totale, realizimi është në masën 94.4%,
Nga të cilat:
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, realizimi është në masën 94.4%,
Shpenzime Kapitale me financim të huaj, nuk parashikohen për këtë program.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm, realizimi është në masën 90.2%.
- Financimi i huaj, nuk parashikohet për këtë program.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projektit

Janë parashikuar 6 produkte/projekte investimi dhe 2 produkte korente, me plan të rishikuar 156,959 mijë lekë, dhe janë realizuar shpenzime në vlerën 141,645 mijë lekë, ose 90.2%, të cilat paraqiten si më poshtë:

Totali i shpenzimeve korente – 83.2%

1. Akte ligjore dhe nënligjore të koordinuara – 72.9%
2. Staf i rekrutuar/trajnuar – 90%

Totali i shpenzimeve për investime – 94.4%

1. Rikonstruksion i godinës për ish ambientet e MZHETTS – 99.9%
2. Sistem ngrohje-ftohje për ambientet e MEKI-së – mbi 99%
3. Blerje pajisje – 68.8%
4. TVSH – detyrim doganor – sipas detyrimit të lindur 98%

Shpenzimet e programit për investime

Nga projektet e parashikuara për investime, pjesa më e madhe është realizuar sipas planifikimit financiar, me nivel shumë të lartë ekzekutimi për projektin kryesor të rikonstruksionit dhe sistemin e ngrohje-ftohjes, ndërsa blerja e pajisjeve paraqet realizim të pjesshëm.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet ndërmjet planit të rishikuar dhe realizimit lidhen kryesisht me procedurat e furnizimit për pajisje dhe pagesat në proces likuidimi, të cilat do të reflektohen në periudhën pasuese.

Programi-Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën 94.1%, nga të cilat:
shpenzime për staf të trajnuar, realizimi është në masën 60.8%,
shërbime dhe procese inovative të zbatuara, realizimi është në masën 92.3%,
akte ligjore dhe nënligjore të miratuara, realizimi është në masën 100%.
- Shpenzime kapitale totale, realizimi është në masën 100%, nga të cilat shpenzime kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 100%, ndërsa financim i huaj nuk parashikohet për këtë program.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm, realizimi është në masën 100%.
Financimi i huaj nuk parashikohet.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projektit

Totali i shpenzimeve korente – 99%

Staf i trajnuar – 60.8%

Shërbime dhe procese inovative të zbatuara – 85%

Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara – 100%

Totali i shpenzimeve për investime – 100%

Kapital fillestar – 100%

Shpenzimet e programit për investime

Për programin 01150 është parashikuar një projekt investimi për kapital fillestar, i cili është realizuar plotësisht gjatë periudhës raportuese.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet e kufizuara në disa produkte korente lidhen me ritmin e realizimit të trajnimeve dhe fazat e zbatimit të shërbimeve inovative, të cilat do të vijojnë në periudhat pasuese.

Programi-Mbështetje për Zhvillim Ekonomik

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 1.6 % të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 91%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën rreth **96%**.
- Shpenzime kapitale totale, realizimi është në masën **56%**, nga të cilat:
 - Shpenzime kapitale me financim të brendshëm –**82.4%**
 - Shpenzime kapitale me financim të huaj – **30.8%**

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën **98%**.
- Financimi i huaj – realizimi është në masën **53%**.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Në kuadër të shpenzimeve korente janë realizuar në nivele të larta aktivitetet lidhur me miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, dhënien e granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, shërbimet për bizneset sipas sistemeve të regjistrimit dhe licencimit, si dhe studimet e fizibilitetit për projektet koncesionare/PPP. Informacion me te detajuar ka Aneksi nr.2.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit kanë përfshirë blerje pajisjesh për institucionet vartëse, rikonstrukcione të pjesshme të ambienteve, fonde për konkurrueshmërinë dhe mbështetjen e biznesit kreativ, si dhe projekte me financim të huaj, përfshirë Programin Italian, projektin IPA II, EEN Albania, Net4Green dhe Digital Innovation Unit. Realizimi i investimeve me financim të brendshëm ka qenë shumë i lartë, ndërsa projektet me financim të huaj janë realizuar pjesërisht në varësi të ecurisë së programeve përkatëse.

Blerje pajisje zyre për AIDA – realizim 90%.

Fondi i konkurrueshmërisë – realizim 98%

Mbështetje për biznesin kreativ – realizim 99%

Pajisje informatike të blera – realizim 100%.

Projekt preventiv i QKB – realizim 100%.

TVSH për projekte me financim të huaj 74%

Programi Italian – realizim 29%.

Financim i huaj për projektin “Cross-Border Cooperation Programme Montenegro–Albania (IPA II)” – realizim 29%.

Projekti EEN Albania – realizim nga 100%

Projekti Net4Green – realizim 0%.

Digital Innovation Unit – realizim 0%.

Fond i ngrirë – pa realizim.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me ritmin e zbatimit të projekteve me financim të huaj, procedurat e prokurimit dhe fazat e likuidimit të pagesave, të cilat kanë sjellë zhvendosje të realizimit në periudhat pasuese.

Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **0.7 %** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **99%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën rreth **98%**.
- Shpenzime kapitale totale, realizimi është në masën **99%**, nga të cilat:
 - Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – **99%**
 - Shpenzime kapitale me financim të huaj – **nuk ka**

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën **99%**.
- Financimi i huaj – **nuk ka**.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Kalibrime dhe verifikime të mjeteve matëse – **98%**

Inspektime për mbikëqyrjen e tregut në të gjithë territorin e vendit – **98%**

Standarde evropiane dhe ndërkombëtare të adaptuara dhe miratuara si SSH – **90%**

Certifikata akreditimi të njohura në vendet ndërkombëtare – **93%**

Anëtarësime në organizata ndërkombëtare të metrologjisë – **85%**

Performanca e shpenzimeve për investime

Blerje pajisje për kompletimin e laboratorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (sensorë dhe pajisje laboratorike) – **99%**

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet minimale nga plani vjetor i rishikuar lidhen me momentin e likuidimit të disa pagesave dhe diferenca të vogla teknike në ekzekutim, pa ndikuar në përmbushjen e objektivave të programit. Ndryshimi i çmimit të blerjes me atë të tenderit për investimet

Programi- Inspektimi ne Pune

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **1%** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **99%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente – realizimi është në masën rreth **99%**.
- Shpenzime kapitale totale – realizimi është në masën **98%**.

Programi financohet vetëm me **financim të brendshëm**.

Sipas burimit të financimit:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën **98%**.
- Financim i huaj – nuk ka.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Inspektimet e realizuara nga ISHPSHSH – **98%**

Shpenzimet e programit për investime

Blerje pajisje të ndryshme për zyra dhe mbrojtje ndaj zjarrit – **90%**

Blerje automjeti – **100%**

Blerje pajisje elektronike (kompjuterë/Laptop) – **72%**

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet minimale nga plani lidhen kryesisht me ritmin e realizimit të disa procedurave të prokurimit dhe likuidimin e pagesave për pajisjet elektronike, ndërkohë që aktiviteti kryesor i programit – inspektimet – është realizuar pothuajse plotësisht sipas planifikimit.

Programi – Strehimi

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **2%** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **96.5%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

-
- **Shpenzime korente** – realizimi është në masën **96%**
 - **Shpenzime kapitale totale** – realizimi është në masën **97%**,

nga të cilat:

- Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – **97.3%**
- Shpenzime kapitale me financim të huaj – **0%**

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën 97.3%
- Financimi i huaj – 0% (nuk ka realizim)

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve

Në kuadër të shpenzimeve korente janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Bonusi i qirasë – **79.1%**
- Kreditë ekzistuese të subvencionuara – **98%** sipas skemave
- Grantet e menjëhershme – **100%**
- Subvencionimi i qirasë për të shpronësuar – **0.8%**

Në tërësi, shpenzimet korente të programit janë realizuar në nivel të kënaqshëm.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit janë realizuar pothuajse në tërësi me financim të brendshëm dhe përfshijnë:

- Përmirësim të kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian – **97.5%**
- Projekte infrastrukturore në zona informale – **96.2%**
- Rikonstruksion të godinave për strehim social – **100%**

Totali i investimeve është realizuar në masën **97.3%**.

Projektet me financim të huaj nuk kanë pasur plan/realizim gjatë periudhës raportuese.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me rishikimin në ulje të disa skemave të subvencionimit dhe ritmin e zbatimit të disa projekteve të strehimit social, megjithatë realizimi në tërësi ka mbetur në nivele shumë të larta, duke reflektuar ecuri të mirë të programit.

Programi-Arsimi i Mesëm (profesional)

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **6.8%** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **92%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente – realizimi është në masën 97.5%.
- Shpenzime kapitale totale – realizimi është në masën 69.3%, nga të cilat:
 - Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – 99.2%
 - Shpenzime kapitale me financim të huaj – 58.0%

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën 99.2%.
- Financimi i huaj – realizimi është në masën 58.0%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Shpenzime korente (produkte/aktivitete)

Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara/miratuara – 57%
Inspektime të ofruesve të AFP-së – 93%
Ofrues të AFP të mbështetur për sigurimin e cilësisë – 8.7%
Mësues të trajnuar dhe atestuar – 94%
Skeletkurikula/programe/materiale mësimore të hartuara – 49.0%
Standarde profesionale dhe kualifikimesh të miratuara – 35.6%
Bursa të përfituara nga nxënësit e AP – 92%
Nxënës që ndjekin shkollat e AP – 99%
Skeletkurikula/materiale mësimore - 97%
Standarde profesionale/kualifikimesh – 74%
Nxënës përfitojnë subvencion tekste mësimore 100%

Shpenzimet e programit për investime

Investime me financim të brendshëm

Mobilje e pajisje për shkollat e AP (18AY501) – 93.9%
Rikonstruksion çatie për repartin e praktikës “Irakli Terova”, Korçë (18AY647) – 96.5%
Rikonstruksion Godina e shkollës Kamëz (IPA 2008) (24AB501) – 99.8%
Rikonstruksion/ndërtim i ri – “Pavarësia”, Vlorë (24AB503) – 99.9%
Rikonstruksion Shkolla “Bajram Curri”, Kukës (24AB505) – 100.0%
TVSH për Projekte të ndryshme (18BS314) – 100.0%
Laboratore/pajisje/makineri për repartet e praktikave profesionale (18AY503) – 100.0%
Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë – Rakip Kryeziu (24AB512) – 100.0%
Kolaudim – SHMP Kamëz (Fond for VET and Employment) (24AB513) – 0%

Investime me financim të huaj

projekte si: Skills for Job; Mbështetje të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit;

PROSEED Arsimi Profesional; EPALE-ADULT LEARNING; EPALE National Support Services; Skemat e Praktikes për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri, janë paraqitur ecuri te kënaqshme.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me ecurinë e projekteve kapitale, ku një pjesë e investimeve (sidomos rikonstruksione/ndërtime) nuk kanë nisur ose janë në faza procedurash, si dhe me ritmin e zbatimit të projekteve me financim të huaj, duke sjellë zhvendosje të realizimit në periudhat pasuese.

Programi -Tregu i Punës

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **5 %** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **95.2%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente – realizimi është në masën 96.4%.
- Shpenzime kapitale totale – realizimi është në masën 52.6%, nga të cilat:
 - Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – 86.5%
 - Shpenzime kapitale me financim të huaj – 6.0%

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën 86.5%.
- Financimi i huaj – realizimi është në masën 6.0%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Shpenzime korente (produkte/aktivitete)

Ndërmjetësime të realizuara nga Zyrat e Punësimit AKPA (90402AA) – **91.8%**
Kursantë në formim profesional sipas VKM nr.646, dt. 05.10.2022 (90402AE) – **51.9%**
Të punësuar/të trajnuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit (90402AH) – **76.0%**
Persona të trajtuar me pagesë papunësie (90402AC) – **81.0%**
Të rinj përfitues të nismës Garancia Rinore (90402AF) – **70.3%**
Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik (90402AG) – **89.2%**
Leje pune për shtetasit e huaj, raportime/statistika/financiare/prokurimi (90402AD) – **88.3%**

Leje pune për shtetasit e huaj (91211AF) – **100.0%**
Persona të trajtuar me pagesë papunësie (91211AG) – **100.0%**
Ndërmjetësime nga Zyrat e Punësimit AKPA (91211AA) – **100.0%**
Të punësuar/të trajnuar nga programet e nxitjes së punësimit (91211AB) – **100.0%**
Kursantë në formim profesional sipas VKM nr.646, dt. 05.10.2022 (91211AE) – **100.0%**

Të rinj përfitues Garancia Rinore (91211AD) – **100.0%**

Të trajnuar në QFP Publik (91211AC) – **100.0%**

Shpenzimet e programit për investime

Investime me financim të brendshëm

Ndërtim i Kampusit të QFP (18AY705) – **100.0%**

Rikonstrukcione Zyra Punësimi / Qendra Formimi Profesional (24AI701) – **65.6%**

Investime me financim të huaj

Realizimi i treguesve të buxhetit në total është 95% në krahasim me planin e rishikuar, pasi nga 2,608,793,000 lekë plan i rishikuar janë shpenzuar 2,483,315,049 lekë. Në mënyrë analitike, realizimi i shpenzimeve korente është 96%, ndërsa realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm (kapitulli 1) është 86%. Në të kundërt, shpenzimet kapitale me financim të huaj (kapitulli 2) paraqesin nivel realizimi 6%, çka reflekton vështirësi në disbursim dhe zbatim të projekteve të financuara nga burime të jashtme gjatë vitit 2025.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me ritmin e zbatimit të investimeve (sidomos projektet me financim të huaj), fazat procedurale dhe likuidimet, si dhe me mos-realizimin/zhvendosjen e disa zërave të planifikuar për periudha pasuese, çka ka ndikuar në nivelin e realizimit të shpenzimeve kapitale.

2. Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Programi -Tregu i Punës

Analiza e realizimit të buxhetit për Programin 10550 “Tregu i Punës” për vitin 2025 bazohet në objektivin kryesor të programit, i cili synon nxitjen e mundësive për punë të denjë, rritjen e punësueshmërisë së forcës së punës nëpërmjet politikave të tregut të punës, përputhjen e kërkesës me ofertën për punë përmes shërbimeve të punësimin, zhvillimin e formimit profesional si dhe mbështetjen me të ardhura për personat e papunë nëpërmjet pagesës së papunësisë.

Sipas produkteve të programit buxhetor, shpenzimet korente kanë realizim 96% dhe shpërndahen në mënyrë domethënëse ndërmjet produkteve kryesore. Produkti që lidhet me ndërmjetësimet dhe këshillimin e realizuar nga zyrat e punësimin (91211AA/90402AA) realizon 99%, duke reflektuar garantimin e funksionimit të shërbimeve të punësimin. Produkti i nxitjes së punësimin (91211AB/90402AH) realizon 93% dhe është karakterizuar nga rritje e planit të rishikuar, në funksion të kërkesës së rritur dhe rikonfigurimit të fondeve brenda programit. Produkti i formimit profesional publik (91211AC/90402AG) realizon 99% dhe evidentohet si një nga komponentët me performancën më të lartë, i shoqëruar edhe me rritje të planit të rishikuar, kryesisht për pagat dhe sigurimet shoqërore të QFP-ve. Produkti i garancisë rinore (91211AD/90402AF) realizon 88% dhe ka reflektuar reduktime të planit të rishikuar gjatë vitit. Produkti i kodimit

(91211AE/90402AE) realizon 83%, me pjesë të fondeve të transferuara drejt programeve të nxitjes së punësimit, ndërsa produkti i pagesës së papunësisë (91211AG/90402AC) realizon 98%, duke garantuar mbështetjen e vazhdueshme financiare për përfituesit.

Në pjesën e investimeve me financim të brendshëm, plani i rishikuar rezulton 41,200,000 lekë dhe janë shpenzuar 35,624,888 lekë, me realizim 86%. Projekti “Ndërtim i Kampusit të QFP” ka realizuar 100% të planit vjetor, ndërsa projekti “Rikonstruksione Zyra Punësimi, QFP” ka realizuar 66%. Investimi për ndërtimin e kampusit mbështetet në kontratën shumëvjeçare të lidhur në fund të vitit 2024 dhe gjatë vitit 2025 është kryer likuidimi i volumit të punimeve në shumën 25,000,000 lekë, bazuar në situacionet e paraqitura. Sa i përket financimit të huaj me kapitull 2, plani fillestar prej 100,000,000 lekësh është rishikuar në 30,000,000 lekë dhe është realizuar vetëm 1,796,620 lekë, me nivel realizimi 6%, çka tregon performancë të dobët të projekteve për shkak të dinamikës së granteve, disbursimeve dhe zhvillimeve të partneriteteve gjatë vitit 2025.

Treguesit e sasisë për Programin 10550 “Tregu i Punës” janë raportuar sipas produkteve, ku në disa raste i njëjti përshkrim produkti paraqitet me dy kode buxhetore për arsye klasifikimi administrativ dhe raportimi financiar sipas grupi ministror ku janë realizuar. Në analizën e realizimit, këto kode janë trajtuar si një tregues i vetëm sasior, duke agreguar vlerat përkatëse në nivel produkti.

Për produktin “Ndërmjetësime të realizuara nga Zyrat e Punësimit AKPA” (91211AA / 90402AA), plani vjetor prej 25,000 ndërmjetësimesh është realizuar në masën 22,539, duke reflektuar një realizim prej rreth 90% të objektivit sasior. Për produktin “Të punësuar / të trajnuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit” (91211AB / 90402AH), kundrejt planit prej 2,000 përfituesish, janë realizuar 2,816, duke tejkaluar objektivin vjetor. Në produktin “Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik” (91211AC / 90402AG), kundrejt planit prej 9,600 personash, janë trajnuar 11,872 persona, çka tregon performancë mbi planin. Programi i Garancisë Rinore (91211AD / 90402AF) ka realizuar 1,692 përfitues kundrejt planit 1,400, ndërsa programi i kodimit (91211AE / 90402AE) ka realizuar 456 pjesëmarrës kundrejt planit 700. Sa i përket produktit “Persona të trajtuar me pagesë papunësie” (91211AG / 90402AC), plani prej 3,300 përfituesish është realizuar me 2,597 persona mesatarisht gjatë vitit.

Në tërësi, analizimi i treguesve të sasisë në nivel përshkrimi produkti, duke bashkuar kodet përkatëse që i referohen të njëjtimit objektiv, jep një pasqyrë më të saktë të performancës reale të programit dhe shmang fragmentarizimin artificial të treguesve për shkak të strukturës së kodifikimit buxhetor.

Për programin - Sigurimet Shoqërore

Për programin 10220 “Sigurimet Shoqërore”, treguesit e sasisë paraqiten në nivel produkti dhe përfaqësojnë numrin e përfituesve/rasteve të trajtuara ose volumet e realizuara gjatë vitit, sipas natyrës së skemës përkatëse. Në rastet kur i njëjti përshkrim i produktit raportohet me më shumë se një kod (për arsye të kodifikimit dhe raportimit financiar), analiza e treguesit të sasisë bëhet duke i bashkuar këto kode në një tregues unik, në mënyrë që të shmanget fragmentarizimi i rezultatit. Për periudhën e raportimit 12-2025, produkti kryesor “Transferte buxhetore për të mbuluar diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së pensioneve publike” paraqet sasi 738,190 në plan të rishikuar dhe të njëjtën sasi në fakt, duke reflektuar stabilitet të treguesit.

Për produktet e përfitimeve suplementare dhe kompensimeve, vërehen lëvizje midis planit dhe faktit në disa zëra, si p.sh. kompensimi i çmimeve me sasi 373,105, kompensimet për të ardhurat e pensionistëve me sasi 239,863, si dhe trajtimi për shpenzime varrimi ku fakti 15,169 është më i ulët se plani 20,524. Po ashtu, “Shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit” rezulton me fakt 69,005 kundrejt planit 72,000. Në tërësi, vlerësimi i treguesve të sasisë në nivel përshkrimi produkti (duke bashkuar kodet kur është e nevojshme) jep një pasqyrë më të saktë të performancës reale dhe e bën krahasimin plan–fakt më të lexueshëm dhe të qëndrueshëm. Info me shume jep aneksi 3.1.

Në përfundim, programi 10220 “Sigurimet Shoqërore” për periudhën 12-2025 paraqet një ecuri të qëndrueshme dhe të konsoliduar, si në aspektin financiar ashtu edhe në realizimin e treguesve sasiorë. Niveli i lartë i realizimit të planit të rishikuar, sidomos në produktet kryesore të transfertave dhe përfitimeve, dëshmon për menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike dhe për garantimin në kohë të detyrimeve ndaj përfituesve. Stabiliteti i treguesve kryesorë, si dhe përputhja e faktit me planin në shumicën e produkteve, reflekton funksionim normal të skemave të sigurimeve shoqërore dhe mbrojtje efektive sociale për kategoritë përfituese. Në tërësi, programi ka përmbushur objektivat e tij, duke siguruar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të skemës.

Programi - Strehimi

Programi i strehimit synon ofrimin e alternativave të përballueshme dhe të përshtatshme për familjet që nuk përballojnë kostot e tregut, në përputhje me Strategjinë Sociale për Strehimin 2016–2025 dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Objektivi afatgjatë është adresimi i nevojave për 35,000 familje deri në vitin 2030.

Deri në fund të vitit 2025 janë adresuar 26,986 familje, duke arritur 77% të objektivit afatgjatë. Janë trajtuar 1,974 përfitues nga kategoritë “viktima të dhunës në familje” dhe “gra kryefamiljare”. Për komunitetin Rom dhe Egjiptian janë adresuar rreth 3,831 familje, ndërsa në projektet e përmirësimit të banesave kjo kategori përbën 9% të përfituesve. Megjithatë, përfshirja në skemën e kredive të reja për këtë kategori ka qenë minimale për shkak të mosplotësimit të kushteve bankare.

Në shpenzimet korrente, buxheti i rishikuar ishte 535,018 mijë lekë dhe realizimi arriti në 511,423 mijë lekë (96.2%). Subvencionimi i interesave për kreditë ekzistuese dhe të reja u realizua mbi 99%, ndërsa bonusi i qirasë në masën 95.9%. Subvencionimi për banorët e shpronësuar nga Unaza e Madhe u realizua në nivel më të ulët (62.2%). Në total, nga subvencionimi i qirasë përfituan 2,297 familje.

Në shpenzimet kapitale u akorduan rreth 570 milionë lekë. U financuan projekte investimi për përmirësimin e kushteve të banimit për kategori vulnerabël, me 35 projekte të reja fituese në vitin 2025, që do të trajtojnë 1,250 familje në dy vite buxhetore. Projektet e nisura në vitin 2024 u realizuan 100%.

Gjatë vitit u kryen rishpërndarje fondesh për të mbuluar mungesën në programin e subvencionimit të qirasë, duke përdorur kursimet nga programet e kredive për shkak të normave të ulëta të interesit.

Përmbledhtazi, për vitin 2025, programi 06190 “Strehimi” ka realizuar treguesit sasiorë në disa produkte kyçe që lidhen drejtpërdrejt me mbështetjen e familjeve dhe përmirësimin e kushteve të banimit. Në kuadër të subvencionimit të kredive ekzistuese janë trajtuar 5,313 përfitues, duke

garantuar vijimësinë e mbështetjes për familjet që janë pjesë e skemës. Për kreditë e reja janë realizuar 490 përfitues, ndërsa përmes bonusit të qirasë janë mbështetur 2,297 familje, në përputhje me planin e rishikuar. Grantet e menjëhershme janë akorduar për 17 raste, ndërsa subvencionimi i qirasë për banorët e shpronësuar nga Unaza e Madhe Tiranë ka mbuluar 218 përfitues.

Në komponentin e investimeve, janë realizuar 281 projekte për përmirësimin e infrastrukturës në zona informale në proces legalizimi, 17 ndërhyrje për rikonstrukcionin e godinave në pronësi të njëjësive të qeverisjes vendore për strehim social, si dhe 766 ndërhyrje për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian. Në tërësi, realizimi i treguesve të sasisë dëshmon për shtrirje të gjerë të ndërhyrjeve dhe orientim të fondeve drejt kategorive prioritare, duke siguruar impakt social të drejtpërdrejtë dhe përmirësim të kushteve të jetesës për përfituesit.

Në përfundim, realizimi financiar dhe fizik për vitin 2025 në shpenzime korrente dhe kapitale arriti rreth 97% të buxhetit të rishikuar. Objektivat kryesore të politikës së strehimit janë përmbushur në nivel të lartë, me theks të veçantë në përfshirjen e kategorive prioritare.

Program - Arsimi i Mesëm Profesional

Gjatë 12-mujorit të vitit 2025, Programi buxhetor 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” ka vijuar zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, me fokus në rritjen e aksesit dhe forcimin e sigurimit të cilësisë në arsimin dhe formimin profesional (AFP). Arsimi profesional ofrohet në 31 shkolla publike me 92 kualifikime të niveleve II–V të KSHK-së dhe përbën rreth 19% të arsimit të mesëm të lartë.

Në vitin shkollor 2024–2025, arsimin profesional publik e ndoqën 15,459 nxënës, prej të cilëve 2,616 vajza, duke reflektuar rritje të qëndrueshme të përfshirjes së vajzave. Në nivelin V të KSHK-së u regjistruan 268 nxënës, 47% e të cilëve femra. Për herë të parë u zbatua sistemi dual, ku 261 nxënës përfituan përvojë praktike në mjedise reale biznesi, duke forcuar lidhjen mes arsimit profesional dhe tregut të punës.

Të dhënat paraprake tregojnë se punësueshmëria e të diplomuarve të vitit 2024, një vit pas përfundimit të studimeve, ka arritur në 63%, krahasuar me 40.23% në vitin 2020, duke shënuar një rritje prej 22.77 pikë përqindje. Njëkohësisht, 19% vijnë studimet dhe 18% janë në kërkim të punës.

Në kuadër të rritjes së aksesit dhe përfshirjes, 4,741 nxënës përfituan bursa me një realizim pothuajse të plotë të buxhetit, ndërsa 3,820 nxënës nga grupet në nevojë përfituan tekste falas. Sistemi përfshiu 188 nxënës me nevoja të veçanta, 539 nxënës nga komunitetet rom dhe egjiptian, si dhe një përqindje të konsiderueshme nxënësish nga zona rurale. Fushatat promovuese, ditët e hapura, orientimi në karrierë dhe nismat për rritjen e pjesëmarrjes së vajzave kanë kontribuar në përmirësimin e imazhit dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në AFP.

Sigurimi i cilësisë ka qenë një prioritet i rëndësishëm gjatë vitit 2025. Janë hartuar dhe miratuar 40 skeletkurrikula dhe programe të unifikuara, si dhe 20 materiale mësimore. Janë miratuar 57 standarde profesionale dhe kualifikimesh dhe është përditësuar Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale, i cili përfshin 154 kualifikime. Gjithashtu, 114 mësimdhënës janë trajnuar ose atestuar, 43 ofrues janë mbështetur në procesin e vetëvlerësimit dhe 6 ofrues kanë kaluar procesin e akreditimit. Janë hartuar 10 akte ligjore dhe janë kryer 9 inspektime për garantimin e standardeve të cilësisë.

Buxheti i rishikuar për vitin 2025 ishte 3,887,600,648 lekë, me një realizim vjetor prej 3,524,426,132 lekë ose 91.57%. Shpenzimet korrente u realizuan në masën 97.5%, ndërsa shpenzimet kapitale të financuara nga buxheti i brendshëm në 99.2%. Investimet me financim të huaj rezultuan me realizim 58%. Investimet në infrastrukturë dhe pajisje, përfshirë rikonstrukcionin dhe modernizimin e disa shkollave profesionale, janë realizuar në nivel shumë të lartë, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e mësimdhënies dhe praktikës profesionale.

Në tërësi, viti 2025 karakterizohet nga rritje e aksesit, përmirësim i treguesve të punësueshmërisë, forcim i mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe realizim i lartë i investimeve në infrastrukturën e arsimit profesional.

Program - Mbështetje për Zhvillim Ekonomik

Për programin 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik”, realizimi për vitin 2025 paraqet një ecuri të qëndrueshme dhe të orientuar drejt ndërhyrjeve me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e sipërmarrjes dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Nga një plan i rishikuar prej 894,888,000 lekësh, janë realizuar 810,548,535 lekë, duke reflektuar një nivel të mirë ekzekutimi financiar dhe një shpërndarje të balancuar të fondeve ndërmjet masave mbështetëse dhe projekteve zhvillimore. Në komponentin e mbështetjes direkte për biznesin, grantet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë realizuar në masën 98,066,268 lekë, ndërsa mbështetja për startup-et ka arritur 285,192,031 lekë, duke treguar fokus të qartë në nxitjen e inovacionit dhe sipërmarrjes së re. Fondi i konkurrueshmërisë dhe mbështetja për biznesin kreativ janë realizuar në nivele të kënaqshme, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe diversifikimin e aktivitetit ekonomik. Shërbimet e ofruara për bizneset përmes sistemit të regjistrimit të biznesit dhe licencave paraqesin realizim të qëndrueshëm, duke garantuar funksionimin normal të proceseve administrative dhe përmirësimin e aksesit të bizneseve në shërbime publike. Po ashtu, promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe studimet e fizibilitetit për projektet koncesionare/PPP kanë vijuar sipas planit të rishikuar, duke mbështetur klimën e investimeve dhe projektet strategjike. Në fushën e investimeve dhe pajisjeve, realizimi ka qenë selektiv, duke u fokusuar në nevojat prioritare, ndërsa disa projekte me financim të huaj dhe zëra të veçantë kanë pasur ritëm më të moderuar zbatimi gjatë vitit. Në tërësi, programi ka arritur të mbështesë instrumentet kryesore të zhvillimit ekonomik, të forcojë kapacitetet institucionale dhe të kontribuojë në nxitjen e aktivitetit sipërmarrës, duke reflektuar menaxhim të kujdesshëm të burimeve dhe orientim të fondeve drejt prioriteteve strategjike.

Në kuadër të zbatimit të Aktit Normativ nr. 10/2025 dhe procesit të riorganizimit institucional të agjencive në rang vendi, sic edhe jemi shprehur me siper janë transferuar dy institucione nga grupi buxhetor 87, konkretisht Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e Startup-eve dhe Lehtësuesve, së bashku me fondet buxhetore përkatëse që u ishin alokuar për vitin 2025.

Në periudhën vjetore 2025, Programi ka shënuar një ecuri pozitive në realizimin e treguesve të sasisë, duke reflektuar një nivel të lartë aktiviteti në shërbimet ndaj biznesit dhe në ndërhyrjet mbështetëse. Në aspektin operacional, pesha kryesore e volumit përqendrohet te shërbimet e ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit, me 163,872 shërbime të realizuara, si dhe te shërbimet sipas sistemit të licencave me 13,024 shërbime. Paralelisht, janë zhvilluar 105 takime për përmirësimin e klimës së biznesit dhe janë realizuar 57 aktivitete në kuadër të promovimit të

Shqipërisë si destinacion investimesh dhe kujdesit ndaj investitorëve. Mbështetja direkte ndaj sipërmarrjes është materializuar edhe përmes 81 kompanive startup të mbështetura dhe 45 granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërsa në komponentin e rregullimit dhe përmirësimit të kuadrit institucional janë realizuar 10 akte ligjore e nënligjore të miratuara. Në tërësi, këta tregues dëshmojnë orientim të qartë drejt rritjes së aksesit të biznesit në shërbime, përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes dhe forcimit të instrumenteve të mbështetjes ekonomike, duke krijuar bazë të mirë për vijimësinë dhe konsolidimin e rezultateve në vitet në vijim.

Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale”

Për vitin 2025, Programi 4160 “Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale” paraqet një nivel të lartë realizimi financiar dhe operacional, duke reflektuar konsolidim të funksioneve kyçe në fushën e metrologjisë, standardizimit, akreditimit dhe mbikëqyrjes së tregut. Nga një plan i rishikuar prej 407,361,000 lekësh, janë realizuar 402,504,191 lekë, çka dëshmon një ekzekutim shumë të mirë të buxhetit dhe përdorim efikas të fondeve.

Në komponentin e kalibrimit dhe verifikimit të mjeteve matëse, realizimi financiar ka qenë pothuajse i plotë, ndërsa në aspektin e volumit janë kryer 28,980 shërbime kalibrimi/verifikimi, duke garantuar besueshmërinë e matjeve në treg dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në fushën e inspektimeve për mbikëqyrjen e tregut janë realizuar 1,450 inspektime, duke kontribuar në rritjen e kontrollit mbi produktet dhe përputhshmërinë me standardet përkatëse.

Sa i përket infrastrukturës së cilësisë, janë adaptuar dhe miratuar 759 standarde evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, ndërsa janë njohur 119 certifikata akreditimi në nivel ndërkombëtar, duke forcuar integrimin e sistemit kombëtar në strukturat evropiane dhe globale të cilësisë. Anëtarësimi me të drejta të plota në organizatat ndërkombëtare (EUROMED, BIPM, WELMEC, OIML, IMECO) është mbështetur financiarisht sipas planit të rishikuar, duke siguruar përfaqësim dhe pjesëmarrje aktive në forumet teknike ndërkombëtare.

Në komponentin e investimeve, është realizuar blerja e 3 sensorëve për kompletimin e laboratorëve, me një nivel të lartë ekzekutimi financiar, duke rritur kapacitetet teknike dhe cilësinë e shërbimeve laboratorike.

Në tërësi, programi ka kontribuar ndjeshëm në forcimin e sistemit të mbikëqyrjes së tregut, rritjen e standardeve të cilësisë dhe harmonizimin me praktikën evropiane, duke krijuar bazë të qëndrueshme për mbrojtjen e konsumatorit, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare dhe përmirësimin e besimit në treg.

Programi - Inspektimi në Punë

Për vitin 2025, Programi 4170 “Inspektimi në Punë” paraqet një nivel të mirë realizimi financiar dhe operacional, duke reflektuar funksionim të qëndrueshëm të strukturave të inspektimit dhe forcim të kapaciteteve mbështetëse. Nga një plan i rishikuar prej 282,371,000 lekësh, janë realizuar 279,059,509 lekë, çka tregon një shkallë të lartë ekzekutimi të buxhetit dhe menaxhim efektiv të fondeve.

Në aspektin e aktivitetit inspektues, janë realizuar 8,674 inspektime nga ISHPSHSH kundrejt 9,000 të planifikuara në planin e rishikuar, duke arritur një nivel shumë të kënaqshëm të mbulimit. Gjithashtu, në kuadër të komponentit përkatës janë realizuar edhe 858 inspektime të tjera, duke kontribuar në forcimin e kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit të punës dhe rritjen e sigurisë në vendin e punës.

Në komponentin e investimeve, është realizuar blerja e 9 automjeteve, duke tejkaluar planifikimin fillestar dhe duke përmirësuar ndjeshëm mobilitetin dhe shtrirjen territoriale të inspektorëve. Po ashtu, janë realizuar investime në pajisje elektronike (kompjuterë) dhe pajisje të tjera për zyra dhe mbrojtjen ndaj zjarrit, duke forcuar infrastrukturën logjistike dhe kushtet e punës së stafit.

Struktura e shpenzimeve reflekton një orientim të qartë drejt funksionit bazë të programit – kryerjes së inspektimeve – me peshë kryesore në shpenzimet për paga dhe mbështetjen operative, ndërsa investimet kapitale janë fokusuar në përmirësimin e kapaciteteve teknike.

Në tërësi, programi ka kontribuar në rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së marrëdhënieve të punës, përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe në forcimin institucional të strukturave inspektuese, duke krijuar premisa të mira për vijimësinë e performancës në vitet në vijim.

Programi - Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji

Për vitin 2025, Programi 1150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji” paraqet një zgjerim të ndjeshëm financiar dhe një nivel shumë të mirë realizimi të treguesve kryesorë. Në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 29.04.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 ‘Për buxhetin e vitit 2025’”, është miratuar rialokimi i fondit si transfertë kapitale në favor të Korporatës së Investimeve Shqiptare, me qëllim pjesëmarrjen e Qeverisë Shqiptare, të përfaqësuar nga kjo korporatë, në startup-in “Thinking Machines Lab”, themeluar nga Mira Murati.

Në aspektin e treguesve të sasisë, programi ka shënuar rezultate konkrete në zhvillimin e kapaciteteve dhe nxitjen e inovacionit. Janë trajnuar 10 punonjës sipas produktit 90408AA dhe 20 punonjës sipas produktit 91204AB, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale. Gjithashtu, janë zbatuar 14 shërbime dhe procese inovative, si në kuadër të produktit 90408AC ashtu edhe 91204AA, ndërsa janë miratuar 5 akte ligjore dhe nënligjore, duke përmirësuar kuadrin rregullator në mbështetje të inovacionit dhe teknologjisë.

Në tërësi, programi ka konsoliduar instrumentet financiare dhe rregullatore në funksion të transformimit teknologjik, duke kombinuar investimin strategjik kapital me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimin e kuadrit institucional, çka krijon baza të qëndrueshme për rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e ekonomisë së bazuar në inovacion.

Programi - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Gjatë vitit 2025, zbatimi i programit “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” u zhvillua në një periudhë me ndryshime të rëndësishme strukturore institucionale, si rezultat i riorganizimit të ministrive dhe krijimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Ky proces ndikoi drejtpërdrejt në mënyrën e planifikimit, alokimit dhe ekzekutimit të fondeve, veçanërisht në ndarjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale ndërmjet institucioneve pasardhëse.

Megjithëse ndryshimet u realizuan gjatë vitit buxhetor, strukturat përgjegjëse arritën të përshtatin proceset financiare dhe administrative, duke garantuar vijueshmërinë e veprimtarisë dhe një nivel të lartë realizimi të treguesve të programit.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 25.09.2025, për riorganizimin e strukturës qeveritare dhe krijimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe në vijim të Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, për ndarjen dhe rialokimin e fondeve buxhetore ndërmjet institucioneve pasardhëse, programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” u krijua si program i ri buxhetor në strukturën e MEI-së.

Në këtë kuadër, u realizua ndarja funksionale e burimeve financiare sipas kompetencave të reja institucionale. Shpenzimet kapitale dhe projektet e investimeve të trashëguara nga ish-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u transferuan në buxhetin e MEI-së dhe u pasqyruan në artikullin 231, duke garantuar vijueshmërinë e projekteve infrastrukturore dhe modernizuese pa ndërprerje proceduriale.

Në të kundërt, shpenzimet korrente u trashëguan dhe u administruan nga MTKS, në përputhje me ndarjen e re institucionale dhe parimin e përputhjes së fondeve me përgjegjësitë funksionale.

Ky proces riorganizimi buxhetor dhe institucional kërkoi përshtatje të menjëhershme në planifikim, raportim dhe menaxhim financiar, duke shtuar kompleksitetin e administrimit gjatë vitit, por njëkohësisht siguroi koherencë funksionale dhe stabilitet në zbatimin e investimeve dhe detyrimeve buxhetore.

Te ardhurat jashtë limit kapitull 06

Gjatë vitit 2025 janë realizuar të ardhura jashtë limitit fillestar të planifikimit, të cilat nuk përbëjnë tejkalim buxhetor, por janë të ardhura të krijuara nga vetë institucionet në bazë të dispozitave ligjore përkatëse që rregullojnë aktivitetin e tyre. Këto të ardhura burojnë nga ofrimi i shërbimeve, tarifave, akteve administrative apo veprimtarive të tjera të lejuara me ligj, dhe janë regjistruar në përputhje me kuadrin e menaxhimit financiar publik. Ato janë pasqyruar në programet përkatëse (4130, 4160, 4170, 10550 dhe 9240) dhe në artikujt 231, 600, 601, 602 dhe 604, duke reflektuar nivelin real të aktivitetit të institucioneve gjatë vitit buxhetor sipas anekseve bashkëlidhur.

Programi	Artikujt kryesorë	Të ardhura të realizuara (lekë)
4130	602	432,645
4160	602	19,768,543
4170	602	588,689
10550	231, 600, 601, 602, 604	56,316,245
9240	231, 600, 601, 602	4,928,926

Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit nëpër programet
Më poshtë paraqiten të dhënat ku Aparati MEI ish MEKI është pjesë e programeve.

Emritet	Ah. e Injës	Kodi i institucionit	Emertimi i Institucionit	Kap	Kodi i Programit	Art	Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Plani Vjetor 2025	FAKT 2025
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	231	24AC801	F.V. Sistem ngrohje ftohje për ish ambjentet e MZHETTS sot MEKI	417,489	374,022
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	231	24A1901	Rikonstruksion i godinës për ish ambjentet e MZHETTS	59,160,000	59,099,561
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	231	M120245	Blerje pajisje	17,242,400	11,818,200
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	04	01110	231	M120199	TVSH - detyrim doganor	3,174	-
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	01110	231	24AC801	F.V. Sistem ngrohje ftohje për ish ambjentet e MZHETTS sot MEKI	21,682,511	21,682,511
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	01110	231	M120245	Blerje pajisje	117,600	117,600
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	04	01110	231	M120199	TVSH - detyrim doganor	136,826	136,826
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	01150	232	24AD901	Kapital Fillëstar	867,200,000	867,200,000
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	04	04130	231	M100332	TVSH për projekte me financim të huaj	4,638,486	-
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	04	04130	231	M100332	TVSH për projekte me financim të huaj	14,150,514	14,150,514
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	18A Y501	Mobilje e Pajisje për shkollat e AP	16,405,920	15,397,920
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	18A Y647	Rikonstruksion çatie për repartin e praktikës (stalle) për shkollën profesionale "Irakli Terova", Korce	72,328	47,771
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	24AB501	Rikonstruksion Godina e shkolles Kames (godina e ndertuar nga IPA 2008)	200,856	197,875
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	24AB503	Rikonstruksion i godinës së shkolles dhe reparteve të praktikave Industriale Pavarisja Vlorë	44,628,105	44,564,083
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	24A B505	Rikonstruksion i shkolles Bajram Curri Kukes	30,000,000	29,999,135
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	24A B508	Rikonstruksion i pjesshem i Shkolles Kolin Gjoka, Lezhe	46	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	231	24AB512	Kolaudim për shkollën e Mësime Profesionale Kamëz në kuadër të projektit me financim të huaj (Fond for VET and Employment)	640,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	04	09240	231	18BS314	TVSH për Projekte te ndryshme laboratore, pajisje, makineri per repartet e praktikave profesionale	4,232,572	4,232,571
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	09240	231	18A Y503	Rikonstruksion çatie për repartin e praktikës (stalle) për shkollën profesionale "Irakli Terova", Korce	74,394,984	74,394,984
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	09240	231	18A Y647	Rikonstruksion Godina e shkolles Kames (godina e ndertuar nga IPA 2008)	637,788	637,788
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	09240	231	24AB501	Rikonstruksion i pjesshem i Shkolles Kolin Gjoka, Lezhe	1,669,650	1,669,650
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	01	09240	231	24AB512	Kolaudim për shkollën e Mësime Profesionale Kamëz në kuadër të projektit me financim të huaj (Fond for VET and Employment)	2,084,936	2,084,936
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	04	09240	231	18BS314	TVSH për Projekte te ndryshme	13,681,815	13,681,815
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	04130	231	18AX304	Programi Italian	51,004,445	-
001	12	1012001	Aparati MEKI	02	04130	231	18AX304	Programi Italian	-	15,041,210
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	04130	231	25AD601	Digital Innovation Unit	2,820,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	04130	231	M040141	Fond I Ngrire	3,000,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	09240	231	18BS301	Skills for Job	192,000,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	09240	231	18BS303	Mbështetje të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit	100,000,000	-
001	12	1012001	Aparati MEKI	02	09240	231	18BS303	Mbështetje të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit	-	50,956,710
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	09240	231	18BS305	Financim i huaj për arsim profesional	109,400,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	02	09240	231	18BS306	PROSEED Arsimi Profesional	158,060,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	600	90401AA	Numer raportesh/ aktesh ligjore dhe nenligjore te ko	20,000,000	14,403,172
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	601	90401AA	Numer raportesh/ aktesh ligjore dhe nenligjore te ko	3,200,000	2,509,386
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	602	90401AB	Staf i rekrutuar/trajnuar	20,000,000	19,640,064
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01110	605	90401AB	Staf i rekrutuar/trajnuar	15,000,000	11,865,000
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01150	600	90408AA	Staf i trajnuar	451	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	01150	602	90408AA	Staf i trajnuar	884,179	537,452
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	01150	600	91204AC	Akte ligjore/nenligjore te miratuara	99,146,642	99,146,642
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	01150	601	91204AC	Akte ligjore/nenligjore te miratuara	13,151,889	13,151,889
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	01150	602	91204AB	Staf i trajnuar	7,365,477	7,365,477
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	04130	602	90409AA	Akte ligjore dhe nenligjore te miratuara	239,345	-
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	04130	602	91205AA	Akte ligjore dhe nenligjore te miratuara	5,385,655	5,385,655
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	600	90403AA	Akte ligjore dhe nenligjore te hartuara/miratuara	319,911	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	600	90403AH	Bursa te perfituara nga nensit e AP	17,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	601	90403AH	Bursa te perfituara nga nensit e AP	3,000	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	602	90403AA	Akte ligjore dhe nenligjore te hartuara/miratuara	15,440,870	1,241,392
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	602	90403AB	Inspektime te Ofruesve te AFP-se	6,500,000	6,024,763
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	09240	606	90403AH	Bursa te perfituara nga nensit e AP	4,391,090	-
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	09240	600	91209AG	Akte ligjore,nenligjore te hartuara/ miratuara hartim/n	10,569,096	10,569,096
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	09240	601	91209AG	Akte ligjore,nenligjore te hartuara/ miratuara hartim/n	1,045,439	1,045,439
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	09240	602	91209AG	Akte ligjore,nenligjore te hartuara/ miratuara hartim/n	6,337,324	6,337,324
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	10220	600	90405AA	Akte ligjore/nenligjore te hartuara	3,475,338	-
001	04	1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (3535)	01	10220	601	90405AA	Akte ligjore/nenligjore te hartuara	380,000	-
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	10220	600	91210AR	Akte ligjore/nenligjore te hartuara	1,174,662	1,174,662
001	12	1012001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	01	10220	601	91210AR	Akte ligjore/nenligjore te hartuara	500,000	500,000
TOTAL									2,024,209,813	1,428,383,095

Përfundimi

- i. Programet që janë transferuar nga grupi 10 në grupin 12, fondet e realizuar në grupin 10 për 4 mujorin e parë të vitit 2024 i janë shtuar duke ndërhyrë në çdo aneks për të rakorduar me MF për faktin e vitit 2024.
- ii. Gjate procesit të hartimit të raporteve të monitorimit, sistemi AFMIS shfaqti probleme teknike, çka e bëri të pamundur përdorimin dhe aksesimin e tij në një periudhë shumë vendimtare për hartimin e anekseve përkatëse. Për këtë arsye, raportet për vitin në fjalë nuk u gjeneruan përmes sistemit AFMIS, por u hartuan manualisht, mbi bazën e të dhënave të disponueshme dhe rakordimeve financiare të kryera nga strukturat përkatëse.
- iii. Gjithashtu, Aneksi 3.2 dhe Aneksi 4 nuk u arrit të hartoheshin as manualisht, jo vetëm për shkak të problematikës teknike, por edhe për shkak të volumit të lartë të të dhënave dhe faktit që kodet e produkteve dhe projekteve janë të shpërndara në tre grupe ministrore. Kjo shpërndarje ka vështirësuar ndjeshëm përpunimin automatik të informacionit, ndërsa krahasimet dhe variancat e gjeneruara nuk do të reflektonin rezultat real.
- iv. Raporti është përgatitur mbi bazën e të dhënave të sistemit SIFQ, sipas gjendjes të fondeve në datën 06.02.2026, pa përfshirë sistemimet apo korrigjimet e kryera nga institucionet pas kësaj date.
Mbetemi në pritje të njoftimit nga ana juaj për fillimin e funksionit të sistemit AFMIS me qëllim përditësimin e të dhënave nga ana jonë.

Ssss